



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), nenit 49 dhe nenit 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 11/11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 28 mars 2019, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR EKSPOZIMET JOPERFORMUESE DHE RISTRUKTURIMET**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktoj dhe të vendos kriteret për ekspozimet jo-përformuese dhe ristrukturimet.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat në Republikën e Kosovës të cilat janë të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në vijim: BQK).

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet mikrofinanciare dhe Institucionet financiare jo bankare" (në vijim: Ligji për banka), dhe/ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - 1.1. **Libri i bankës** - përfshinë të gjitha zërat e bilancit dhe zërat jashtë bilancit të një banke, përveç atyre që konsiderohen si pozicione të librit tregtar;
  - 1.2. **Niveli i Huamarrësit** - përfshijnë të gjithë personat juridik në grupin e huamarrësve të cilët janë me kontabilitet të konsoliduar dhe personave fizikë që kontrollojnë atë grup;

- 1.3. **Borxhi** - përfshinë huat, letrat me vlerë të borxhit dhe zotimet e pa shfrytëzuara të revokueshme dhe të parevokueshme, por përjashton ekspozimet e mbajtura për tregtim;
- 1.4. **Ekspozimet**- përfshijnë të gjitha instrumentet e borxhit (huat dhe paradhëniet dhe letrat me vlerë të borxhit) dhe ekspozimet jashtë bilancore, përjashtuar ekspozimet të mbajtura për tregtim. Ekspozimet jashtë bilancore përfshijnë zërat e revokueshëm dhe të parevokueshme si në vijim: zotimet e pa shfrytëzuara, garancionet financiare dhe zotimet e tjera;
- 1.5. **Vështirësitë financiare** - janë vështirësitë që janë shfaqur ose do të shfaqen nga huamarrësi në shlyerjen e detyrimeve të tij, të cilat vlerësohen në nivelin e huamarrësit dhe/ose të një grupi huamarrësish në bazë të konsoliduar me qëllim të përpilimit të pasqyrave financiare të konsoliduar, nëse huamarrësi i përket një grupi personash të ndërlidhur;
- 1.6. **Shuma materiale domethënëse** - është shuma më e madhe se 1% e një llogarie të arkëtueshme të bankës, por jo më pak se njëqind (100) euro në rastin e huamarrësve të ekspozimit ndaj portfoliove me pakicë –(“retail”) ose pesëqind (500) euro në rastin e huamarrësve të ekspozimit ndaj portfoliove jo me pakicë ( “non – retail”).
- 1.7. **Ekspozimi në vonesë** – nënkupton ndonjë shumë të principalit, interesit ose tarifës që nuk është paguar në datën e arritjes.
- 1.8. **Periudha provuese për ekspozimet e ristrukturuara** - është një periudhë prej së paku dy viteve nga data kur ekspozimet e ristrukturuara janë klasifikuar si performuese.
- 1.9. **Ekspozim ndaj portfoliove jo me pakicë** (ang.“**Non-retail**”) nënkupton ekspozimin ndaj të gjitha kategorive të shoqërive tregtare siç janë të klasifikuara në nenin 5 të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.
- 1.10. **Ekspozim ndaj portfoliove me pakicë (ang.“retail”)** nënkupton ekspozimin ndaj personit fizik ose personit juridik që nuk i plotëson kriteret për tu klasifikuar sipas nenit 5 të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim;
- 1.11. **Rifinancimi i ekspozimit** - nënkupton përdorimin e kontratave të borxhit për të siguruar pagesën totale ose të pjesshme të kontratave të tjera të borxhit kushtet aktuale të të cilave huamarrësi nuk është në gjendje të përmbushë.

### **Neni 3**

#### **Përkufizimi i ekspozimeve jo-përformuese**

1. Banka do të klasifikojë ekspozimet si ekspozime jo-përformuese nëse një ose të dy kriteret e mëposhtme janë plotësuar:
  - 1.1. Ekspozimet materiale janë më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë në vonesë;

- 1.2. Huamarrësi është vlerësuar me paaftësi pagese për të shlyer detyrimet e tij kreditore plotësisht, pa realizimin e kolateralit, pavarësisht shumës ose ditëve në vonesë;
2. Për qëllim të paragrafit 1 të këtij neni përkufizimi i ekspozimeve jo-përformuese do të aplikohet në kreditë bilancore, në letrat me vlerë të borxhit dhe në shuma të tjera në vonesë (interesat dhe komisionet) që një bankë përfshinë në librin e saj bankar me qëllim të llogaritjes së kapitalit. Ky përkufizim do të aplikohet edhe për zërat jashtë bilancit (zotimet e pa shfrytëzuara dhe garancionet).
3. Klasifikimi, si një ekspozim jo-përformues i përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të aplikohet pavarësisht klasifikimit të një ekspozimi si të dështuar për qëllime rregullative në përputhje me nenin 10 të Rregullores për Menaxhimin e Rrezikut të Kreditor ose si të çvlerësuar për qëllime kontabiliteti.
4. Ekspozimet për të cilat konsiderohet se kanë dështuar në përputhje me nenin 10 të Rregullores për Menaxhimin e Rrezikut të Kreditor dhe ekspozimet që janë çvlerësuar në përputhje me kornizën e SNRF-ve, do të konsiderohen si ekspozime jo-përformuese.
5. Ekspozimet do të klasifikohen për gjithsej shumën, pa marrë parasysh kolateralin.
6. Një zotim do të konsiderohet si një ekspozim jo-përformues për shumën nominale, i cili nëse do të tërhiqej ose shfrytëzohet në mënyrë tjetër, do të çonte në ekspozime që paraqesin rrezikun e mos pagesës së plotë, pa realizimin e kolateralit.
7. Garancionet do të konsiderohen si ekspozime jo-përformuese për shumën nominale të tyre kur garancioni është në rrezik të thirret nga pala tjetër (pala përfituese), duke përfshirë, në veçanti, kur garancioni është ekzekutuar dhe përmbush kriteret për tu konsideruar si jo-përformuese. Kur pala e kontraktuar është në vonesë për vlerën e detyrimit sipas kontratës së garancionit, banka do të vlerësojë nëse të arkëtueshmet rezultojnë të kenë përmbushur kriteret për tu klasifikuar si jo-përformuese.

#### **Neni 4**

##### **Vlerësimi i ekspozimeve jo-performuese**

1. Ekspozimet do të vlerësohen si jo-përformuese në baza individuale ("qasja e transaksionit") ose duke marrë parasysh ekspozimin e përgjithshëm ndaj një huamarrësi të caktuar ("qasja e huamarrësit").
2. Ekspozimet jo-përformuese që janë të dështuara ose të çvlerësuar, do të vlerësohen sipas qasjeve të parapara në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor, respektivisht që përdoren për njohjen e çvlerësimit sipas SNRF.
3. Nëse një bankë ka ekspozime në bilanc ndaj një huamarrësi që është në vonesë më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë, vlera kontabël bruto e të cilave përfaqëson më shumë se njëzetë për qind (20%) të vlerës kontabël bruto të të gjitha ekspozimeve në bilanc të atij huamarrësi, i tërë

ekspozimi bilancor dhe jashtë bilancor ndaj atij huamarrësi duhet të konsiderohet si jo-përformues.

4. Kur një huamarrës i takon një grupi ose grupi të palëve të ndërlidhura, duhet të vlerësohet nëse ekspozimet ndaj subjekteve të tjera të grupit konsiderohen si jo-përformuese, kur ato nuk janë konsideruar tashmë si të çvlerësuara ose të dështuara në pajtueshmëri me Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor.

## **Neni 5**

### **Riklasifikimi i ekspozimeve jo-përformuese në përformuese**

1. Ekspozimet mund të konsiderohen se kanë pushuar së qenuri jo-përformuese kur plotësohen të gjitha kriteret e mëposhtme:
  - 1.1. Ekspozimi i plotëson kriteret e largimit të aplikuar nga banka raportuese për ndërprerjen e çvlerësimit dhe klasifikimit si i dështuar;
  - 1.2. Situata e huamarrësit është përmirësuar deri në atë masë sa që shlyerja e plotë, sipas kontratës origjinale ose të kushteve të modifikuara, ka mundësi të bëhet;
  - 1.3. Ri pagesat janë bërë gjatë një periudhe të vazhdueshme prej gjashtë muaj;
  - 1.4. Huamarrësi nuk ka më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë vonesë.
2. Një ekspozim do të mbetet i klasifikuar si jo-përformues, derisa kriteret nga paragrafi 1 i këtij neni të plotësohen, edhe pse ekspozimi i ka përmbushur tashmë kriteret e ndërprerjes të aplikuar nga banka për çvlerësim dhe dështim.
3. Kur kreditë e ristrukturuara janë klasifikuar si jo-përformues, ekspozimet mund të konsiderohen se kanë pushuar së qenuri jo-përformuese vetëm kur plotësohen të gjitha kriteret e mëposhtme:
  - 3.1. Aplikimi i ristrukturimit nuk rezulton me njohjen si e çvlerësuar ose e dështuar;
  - 3.2. Një vit ka kaluar që kur është ristrukturuar (përfunduar greis periudhën ose moratoriumin);
  - 3.3. Sipas kushteve të ristrukturimit nuk ka ndonjë shumë në vonesë ose shqetësim në lidhje me ri pagimin e plotë të ekspozimit të ristrukturuar, që duhet përcaktuar sipas një analize të gjendjes financiare të huamarrësit.
4. Nëse të gjitha kriteret e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, nuk plotësohen në fund të periudhës njëvjeçare, ekspozimi vazhdon të identifikohet si ekspozim i ristrukturuar si jo-përformues, derisa të përmbushen këto kritere. Kriteret duhet të vlerësohen të paktën në baza tremujore.

## Neni 6

### Përkufizimi i ekspozimeve të ristrukturuara

1. Ekspozimet e ristrukturuara janë kontrata borxhi të cilave u janë ndryshuar kushtet me anë të ristrukturimit. Masat e ristrukturimit përbëhen nga lehtësimet ndaj një huamarrësi që ka shfaqur ose do të shfaqë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të tij ("vështirësi financiare"). Vështirësitë financiare do të vlerësohen në nivelin e huamarrësit.
2. Ekspozimet do të trajtohen si të ristrukturuara në qoftë se është bërë një lehtësim, pavarësisht nëse ndonjë shumë është në vonesë, e çvlerësuar në përputhje me SNRF-ën ose e klasifikuar si të dështuar në përputhje me Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut të Kreditor.
3. Për qëllimin e kësaj rregulloreje, lehtësirat i referohen njëres nga veprimet e mëposhtme:
  - 3.1. Një modifikim të afatit dhe kushteve të mëparshme të kontratës të cilat huamarrësi konsiderohet i paaftë për ti përmbushur për shkak të vështirësive financiare ("borxh me probleme");
  - 3.2. Një rifinancim total ose i pjesshëm i një kontrate të borxhit me probleme, që nuk do të ishte dhënë nëse huamarrësi nuk do të kishte vështirësi financiare.
4. Një modifikim që përfshinë pagesat e bëra duke marrë në posedim kolateralin do të trajtohet si një masë e ristrukturimit nëse modifikimi përbën një lehtësim.
5. Ekziston një supozim i kundërshtueshëm se ristrukturimi ka ndodhur në ndonjë nga rrethanat vijuese:
  - 5.1. Kontrata e modifikuar ka qenë krejtësisht ose pjesërisht në vonesë për më shumë se 30 ditë (pa qenë jo-performuese) të paktën një herë gjatë tre muajve para modifikimit të saj ose do të ishte më shumë se tridhjetë (30) ditë në vonesë, tërësisht ose pjesërisht, pa modifikime;
  - 5.2. Njëkohësisht, me ose afërsisht periudhës së lehtësirave të borxhit shtesë nga banka , huamarrësi ka bërë pagesa të principalit ose të interesit në një kontratë tjetër me institucionin që ka qenë tërësisht ose pjesërisht tridhjetë (30) ditë në vonesë së paku një herë gjatë tre muajve para ri financimit;
  - 5.3. Banka miraton përdorimin e ristrukturimit për huamarrësit me 30 ditë vonesë, ose huamarrësi do të jetë tridhjetë (30) ditë vonesë pa ushtrimin e këtyre lehtësirave.
6. Vështirësitë financiare do të vlerësohen në nivelin e huamarrësit siç përcaktohet në paragrafin 5 të nenit 2 të kësaj rregulloreje. Ekspozimet nuk do të trajtohen si të ristrukturuara kur huamarrësi nuk është në vështirësi financiare.
7. Menaxhmenti i bankave duhet të dokumentojë në dosjet e kredive të çdo klienti bazën e ristrukturimeve për çdo ekspozim kredie dhe duhet të përgatisë një listë të ekspozimeve të ristrukturuara (të riprogramuara) për rishikim periodik nga Bordi i Drejtorëve ose Komiteti i Menaxhimit të Riskut. Ekzaminerët e BQK-së do t'i shqyrtojnë listat dhe dosjet përkatëse gjatë

ekzaminimeve në vend të secilës bankë për të vërtetuar politikat dhe praktikat e ristrukturimit të institucionit.

8. Ekspozimet e ristrukturuara duhet të kenë (me shkrim) planin e pagesës. Plani i pagesës duhet të përshtatet me natyrën e biznesit të huamarrësit.

## **Neni 7**

### **Kriteret për daljen nga kategoria e ekspozimeve si të ristrukturuara**

1. Kategorizimi si ristrukturim do të ndërpritet kur të plotësohen të gjithë kushtet si në vijim:
  - 1.1. Kontrata konsiderohet si përformuese pas një analize të gjendjes financiare të huamarrësit, është riklasifikuar nga kategoria jo-përformuese dhe ka treguar se nuk ekzistojnë më kushte për t'u konsideruar si jo-përformuese;
  - 1.2. Ka kaluar periudha provuese minimale dy (2) vjeçare nga data kur ekspozimi i ristrukturuar është konsideruar si performues (përfunduar grejs periudhën ose moratoriumin);
  - 1.3. Asnjë nga ekspozimet ndaj huamarrësit nuk është më shumë se tridhjetë (30) ditë në vonesë gjatë periudhës provuese.
2. Nëse të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni nuk plotësohen në fund të periudhës provuese, ekspozimi vazhdon të trajtohet si ristrukturim përformues derisa të plotësohen këto kushte. Kushtet duhet të vlerësohen të paktën në baza tremujore.
3. Ekspozimet e ristrukturuara mund të jenë përformuese dhe jo-përformuese. Kur ristrukturimi është aplikuar në ekspozimet jo-përformuese, ekspozimi duhet të mbetet jo-përformues. Kur ristrukturimi është aplikuar në ekspozimet përformuese, banka duhet të vlerësojë nëse ekspozimet i plotësojnë kriteret për jo-përformuese edhe nëse ristrukturimi ka rezultuar me ekspozim të ri. Të gjitha ekspozimet e ristrukturuara jo-përformuese duhet të mbeten jo-përformuese derisa të plotësojnë kriterin në nenin 3 paragrafi 1 të kësaj rregulloreje.
4. Nëse një ristrukturimi përformues gjatë periudhës provuese i shtohen masat e ristrukturimit ose kalon më shumë se 30 ditë vonesë, do të klasifikohet si jo-përformuese.
5. Bankat nuk duhet të përdorin praktikën e ristrukturimit për të shmangur kategorizimin e kredive si jo-përformuese. Prandaj, ndalohen përmirësimet e një ekspozimi jo-përformues duke lejuar masat e ristrukturimit dhe kërkohet një kategorizim i veçantë për ekspozimet e ristrukturuara.
6. Bankat duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë kategorizimit të duhur të ekspozimeve të cilat janë ristrukturuar me shumë se njëherë. Kur një ekspozim i ristrukturuar në periudhën provuese ristrukturohet përsëri, kjo duhet të shkaktojë ri fillimin e periudhës provuese dhe bankat duhet të marrin në konsideratë nëse ekspozimi duhet të kategorizohet si jo-përformues. Kur një ekspozim bëhet jo-përformues gjatë dymbëdhjetë (12) muajve të periudhës provuese, periudha provuese fillon përsëri.

## **Neni 8**

### **Raportimi në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës**

Bankat duhet t'i dorëzojnë formularët e raportimit të BQK-së të përcaktuara nga BQK-ja sipas Rregullores për raportimin e bankave jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo muaji, me raporte të tjera të rregullta mujore.

## **Neni 9**

### **Dispozitat kalimtare**

Bankat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje deri me 01 janar 2020.

## **Neni 10**

### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Bankat.

## **Neni 11**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës